

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	U dënuan me 81 vite burg, Veliaj: Ish-krerët e UÇK-së të shpallen 'Qytetarë Nderi' të Tiranës
ADRESA	https://dosja.al/politike/u-denuan-me-81-vite-burg-veliaj-ish-kreret-e-uk-se-te-shpallen-qytetare-i515000
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 12:16:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 12:05:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	edd38a7b93aa9fc99455e93140e12a1eec8cb1a94a2dc259f37b4a54f558cddf
TEKSTI	c3dd497600b3287c1a981e05b7fed637f6dd0a240da776cb587a0be8656c7110
PAMJA	543edcd3ea4cda92f37745bf9d62d6259c7f18f08ab7943c0dafa82e1ed8f687

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	983a0514921fa41d2f2084d3a5384f0b5599e83a822e1cb876b938a6cd5f65f7
E MËPARSHMJA	eb552e34077d7c74235d29b6adf4a739b74618858fb12672242da26218757e17
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/983a0514921fa41d2f2084d3a5384f0b5599e83a822e1cb876b938a6cd5f65f7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

2 ORE ME PARE

Krim në familje/ I moshuari godet me thikë gruan, humb jetën në spital. Shqërohet dhëndëri i tyre në Polici

18 ORE ME PARE

111 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Rama, jepe dorëheqjen

1 DITE ME PARE

Pas vendimit të Hagës, Prishtina ngrihet në protestë/ Policia kërkon dokumente identifikimi për pjesëmarrësit, protestuesit kundërshtojnë

1 DITE ME PARE

"Protestat ndaj qeverisë janë demokraci"/ Rama: Gjykata Kushtetuese nuk i dikton Kuvendit si të votojë, të kërkojë rritje sa herë rriten pagat e të tjerëve është lajthitje

Politike

U dënuan me 81 vite burg, Veliaj: Ish-krerët e UÇK-së të shpallen 'Qytetarë Nderi' të Tiranës

Në një deklaratë nga izolimi, Veliaj tha se propozimi vjen pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj katër ish-drejtimesve të UÇK-së, të cilët u dënuan me 81 vite burg në total.



19 Shtator 2026, 14:05
Nga I.A



Ish-krerët e UÇK

TIRANË- Kryebashkiaku i arrestuar i Tiranës Erion Veliaj ka propozuar që Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi të shpallen "Qytetarë Nderi" të Tiranës. Në një deklaratë nga izolimi, Veliaj tha se propozimi vjen pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj katër ish-drejtimesve të UÇK-së, të cilët u dënuan me 81 vite burg në total.

Veliaj u shpreh se procesi juridik duhet të vijojë rrugën e tij dhe për këtë deklaroi se do t'i propozojë këshillit bashkiak që ish-krerët të shpallen 'Qytetarë Nderi'. Veliaj në mesazhin e tij u ka bërë thirrje edhe kryetarëve dhe këshillave bashkiakë të qyteteve të tjera shqiptare që të ndërmarrin të njëjtën nismë.

Mesazhi i Veliajt:

Të nderuar qytetarë të Republikës së Shqipërisë, të dashur qytetarë të Tiranës, të dashur shqiptarë kudo që jeni. Po bëj 19 muaj në izolim. Nëntëmbëdhjetë muaj pa mundësinë reale për të ushtruar mandatinkushtetues që më kanë besuar qytetarët e Tiranës me një rekord historik votash. Vetëm pak ditë më parë u mor një tjetër vendim gjyqësor që ishte një grusht institucional ndaj demokracisë vendore. Natyrshëm, mund të prisnit që sot t'ju flisja për këtë. Por ka momente në jetën e një njeriu kur drama e tij personale bëhet e vogël, përpara një çështjeje kombëtare. Vendimi i dhënë në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit më ka tronditur thellë. Sigurisht procesi juridik ka rrugën e vet dhe drejtësia duhet të ndjekë deri në fund procedurat dhe standardet e saj. Por ne shqiptarët kemi edhe përgjegjësinë për të kujtuar.

Për të kujtuar si liria e Kosovës erdhi pas dekadash represioni, dhimbjeje dhe rezistence, pas familjesh të dëbuara nga shtëpitë e tyre, jetësh të humbura dhe sakrificash të jashtëzakonshme, pas vendimit të një populli për të mos pranuar më që fati i tij të përcaktohej nga të tjerët. Në atë histori, Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka vendin e saj të

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 19 SHTATOR 2026, 12:14

EMRAT+DETAJE/ Burri vrau gruan në banesë, zbulohen identitetet, në shtëpi dhe nipi 14-vjeçar

AKTUALITET 19 SHTATOR 2026, 12:06

Krim në familje/ Burri godet me thikë gruan, humb jetën në spital për shkak të plagëve

lavdishëm, sikurse ushtarët e saj Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Ata janë katër burra që historia i vendosi në një prej kapitujve më të vështirë dhe më vendimtarë të Kosovës. Kam jetuar dhe punuar në Kosovë, e njoh nga afër Hashimin. Ndaj sot dua që Tirana të flasë. Tirana nuk është vetëm kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë, por kryeqendra e shqiptarisë. Për këtë arsye, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, do t'i propozoj Këshillit Bashkiak që: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi të shpallen Qytetarë Nderi të Tiranës.

Sigurisht jo për ta zëvendësuar drejtësinë me politikën. Jo për t'i treguar një gjykatë se çfarë duhet të vendosë. Por për të ushtruar të drejtën e qytetit tonë për të shprehur mirënjohjen dhe vlerësimin e vet për kontributin e tyre historik në rugëtimin e Kosovës drejt lirisë dhe shtetësisë. Tirana fatkeqësisht nuk mund t'ua japë dot lirinë. Por Tirana duhet t'i nderojë ata. E nga Tirana dua t'u drejtohem edhe kryetarëve dhe këshillave bashkiakë të qyteteve të tjera shqiptare, të nderojnë si Tirana. Pasi këta katër burra nuk janë pjesë vetëm e historisë së një qyteti. Ata janë pjesë e historisë së Kosovës dhe përmes saj, e historisë sonë shqiptare. Le t'u tregojmë familjeve të tyre se nuk janë vetëm. Le t'u tregojmë shqiptarëve të Kosovës se Shqipëria nuk e harron Kosovën. Le t'u tregojmë brezave që vijnë se një shoqëri mund të respektojë drejtësinë dhe njëkohësisht, të ruajë kujtesën e vet historike.

Prandaj sot, nga vendi ku ndodhem, dua t'u them Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit: Procesi juaj juridik do të vazhdojë. Drejtësia do të ndjekë rrugën e saj. Por edhe kujtesa jonë do të ndjekë të vetën. Nuk do ta harrojmë Kosovën e represionit dhe të dëbimeve. Nuk do t'i harrojmë ata që humbën jetën. Nuk do t'i harrojmë familjet që sakrifkuan gjithçka dhe nuk do ta harrojmë kontributin e atyre që morën përgjegjësi në luftë dhe më pas në ndërtimin e shtetit të Kosovës. Unë mund të jem sot pas një dere të mbyllur, por pikërisht këtu kam kuptuar edhe më mirë diçka shumë të thjeshtë: liria është një nga ato fjalë, peshën e plotë të së cilës e kupton edhe më fort kur të mungon.

Ndoshta prandaj sot e ndiej Kosovën edhe më afër. Sepse historia e saj na kujton se liria nuk bëhet e përjetshme vetëm sepse është fituar një herë. Ajo ruhet. Mbrohet. Kujtohet. Nderohet. Për ata që nuk arritën ta shihnin ditën e saj. Për familjet që paguan çmimin e saj. Për të gjithë ata që luftuan dhe punuan për të. Për Kosovën. Për lirinë. Për kujtesën tonë kombëtare. Ata duhet dhe do jenë nderi i kryeqytetit tonë, Tiranës.

erion veliaj

Sondazh

Poll

AKTUALITET 19 SHHTATOR 2026, 11:50

Çfarë ndodhi në Tiranë?
Qëllohet me armë zjarri në
ajër, plagoset lehtë një person

më të klikuarat

EKSKLUZIVE/ Erion Veliaj
del nga qelia, kryebashkiaku
shtrohet në spitalin Salus

Pagat e magistratëve/ Shefja
e Thesarit Tiranë: Krevja
pagesën e muajit Gusht 2026.
Rrogat i bllokoi Malaj...

Kuvendi miratoi formulën e
re të pagave, magistratët
nuk tërhiqen: Do e çojmë në
Gjykatën Kushtetuese

Emri i një pensionisti u
përdor për ndryshimin e 45
identiteteve. Pezullohen 2
zyrtarë, Indrit Aliu shpallet
në kërkim

insights

Auron Janku

Kur PARTITË
harrojnë pse
ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1
euroshit ku Rama
zgjedh kush bëhet
biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi
shqiptar për tu
përshtatur me
tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e
"shkarkoi" sot Edi
Ramen?

Moti

Powered by tomorrow

Politike

19 Shhtator 2026, 13:57

"Është mik i ngushtë me kreun e SPAK"/ Berisha:
Demo është i gatuar me bandat me të rrezikshme të
vendit

Sali Berisha Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka hedhur
akuza ndaj Ministrisë Ervin Demo, duke pretenduar se ai është i
lidhur me di...



Berisha: Bajram Begaj ka plaçkitur prona dhe i ka ndarë me Ramën, atë e kap gjyqi ushtarak dhe mund të ketë dënime më të rënda

Politike

19 Shtator 2026, 13:21

Berisha: Ministrja e re e Shëndetësisë është thjesht një kukull në duart e zeza të Surrelit

Politike

19 Shtator 2026, 13:15

Vendimet e Gjykatës Speciale/ Berisha: Asgjë nuk e nxin luftën Çlirimtare të Kosovës, duhet një ekip i fuqishëm dhe kompetent për të bërë apelimin

Politike

19 Shtator 2026, 12:39

Berisha zbulon angazhimin e diasporës: Janë të gatshëm për të mbështetur përpjekjet e opozitës për të çmontuar këtë regjim

Politike

19 Shtator 2026, 12:26

Politike

19 Shtator 2026, 11:02

Operacioni për pronat në Fier, arrestohen 4 persona/ Në hetim mbi 1,143 hektarë tokë dhe 150 mijë euro

Prokuroria e Fierit FIER- Një ish-drejtor i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në Fier, një përfitues pronash dhe nj...

Bllokimi i llogarive që postonin mbi protestat në Shqipëri/ Ligjvënësit evropianë kërkojnë hetim ndaj Meta-s: Është censurë

Politike

18 Shtator 2026, 20:22

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Christopher Hill: Thaçi nuk ka qenë i përfshirë në vepra të paligjshme

Politike

18 Shtator 2020, 19:20

BE-ja i përgjigjet Kurtit dhe Ramës për vendimin e Hagës: Specialja jep drejtësi të paanshme

Politike


18 Shtator 2020, 18:20

Akuza për vrasjen e Behajdin Allaçit/ Reagon avokati i Thaçit: Prova jashtëzakonisht të brishta dhe të pakonfirmuara

Politike

18 Shtator 2020, 16:00

MË SHUMË



Berisha: Bajram Begaj ka plaçkitur prona dhe i ka ndarë me Ramën, atë e kap gjyqi ushtarak

Prishtina proteston për vendimin e Hagës, djali i Thaçit e Veselit mes protestuesve

Dita e 111-të e protestës/ Mbyllet fjalimet, nis marshimi i qytetarëve në rrugët e Tiranës

Protesta në Tiranë/ Nis marshimi drejt Kryeministrit, thirrje: Jepe dorëheqjen

Berisha: Bajram Begaj ka plaçkitur prona dhe i ka ndarë me Ramën, atë e kap gjyqi ushtarak

▶ Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetare e rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [\[email protected\]](mailto:)



AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

Drejtor: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.